



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Parashtrimin nga Prokuroria të Transkripteve të Propozuara Publike
me më pak Redaktime (W01140)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

**Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e
Dëshmitarëve**
Shefit të Zyrës

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(2), 23 dhe 40(6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 80, 84(1) dhe 116(4)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 nëntor 2023, Trupi Gjykses lëshoi urdhër gojor për rishikimin e pjesëve të transkripteve të mbajtura në seanca private për shkak të riklasifikimit të tyre, duke përcaktuar procedurën që duhej të ndiqnin palët dhe pjesëmarrësit.¹
2. Më 28 shkurt 2024, W01140 dha dëshmi në këtë proces gjyqësor.²
3. Më 15 prill 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime ("Parashtrimet") lidhur me transkriptin e dëshmisë së W01140-s ("transkripti i W01140-s"), të cilave iu bashkëngjiti propozime përmbledhëse të një versioni publik me më pak redaktime të transkripteve ("Shtojca 1 e Parashtrimeve").³
4. Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") dhe Mbrojtja e Viktimave iu përgjigjën *inter partes* ZPS-së,⁴ duke bërë të ditur se: (i) ZMMD-ja pajtohet me redaktimet e propozuara të ZPS-së dhe propozon redaktime shtesë; dhe (ii) Mbrojtja e Viktimave pajtohet, përgjithësisht, me redaktimet e propozuara të ZPS-së dhe propozon redaktime shtesë të dëshmisë së W01140-s, por vlerëson se disa redaktime mund të hiqen pasi nuk janë identifikuese.⁵ Ekipet e Mbrojtjes nuk dorëzuan përgjigje ndaj Parashtrimeve.

¹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, f. 9444, rreshti 14 deri në f. 9446, rreshti 21.

² Transkriptet e seancës, 28 shkurt 2024, f. 13015-13134.

³ F02238, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Transkripteve të Propozuara me më pak Redaktime (W01140)* ("Parashtrimet"), 15 prill 2024, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ Parashtrimet, para. 1.

⁵ *Shih, p.sh., Shtojcën 1 të Parashtrimeve*, f. 43.

II. DISKUTIM

5. Sa i takon transkriptit të W01140-s, ZPS-ja parashtron se redaktimet e propozuara janë të domosdoshme për të mbrojtur identitetin e dëshmitarit.⁶ ZPS-ja vlerëson se redaktimet që propozon ZMMD-ja në lidhje me gjininë nuk janë të nevojshme.⁷ Së fundi, ZPS-ja nuk pajtohet me propozimin e Mbrojtjes së Viktimave për të hequr redaktimin në një paragraf të caktuar.⁸

6. Trupi Gjykses rikujton se W01140-s iu miratuan si masa mbrojtëse në sallën e gjyqit pseudonimi, ndryshimi i pamjes dhe zërit dhe seanca të mbyllura ose private për të gjitha diskutimet dhe dëshmitë në sallën e gjyqit, për të parandaluar identifikimin nga publiku.⁹ Trupi Gjykses është bindur se redaktimet e propozuara nga ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave janë të domosdoshme dhe proporcionale për të mbrojtur identitetin e W01140-s. Për rrjedhojë, pjesët përkatëse të dëshmisë së W01140-s duhet të jenë konfidenciale.

7. Sa u takon propozimeve të ZMMD-së, Trupi Gjykses pajtohet me ZPS-në që redaktimet lidhur me gjininë nuk janë të nevojshme për W01140-s dhe palët e treta, pasi ky informacion nuk është identifikues. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë redaktimet e propozuara nga ZMMD-ja në: f. 13043, rreshti 9, ku përmendet “Mr.”; f. 13048, rreshtat 23 dhe 24, ku përmendet “man”; f. 13068, rreshtat 7, 10, 16, 18 ku përmendet “her”; f. 13069, rreshti 15 ku përmendet “he” dhe “his”; f. 13122, rreshti 20 ku përmendet “he”; dhe f. 13125, rreshtat 3, 4, ku përmendet “him”.

8. Në interes të garantimit deri në masën më të madhe të mundur të parimit të procesit publik, Trupi Gjykses vlerëson se çdo pjesë e dëshmisë së W01140-s që

⁶ Shtojca 1 e Parashtrimeve, f. 3, para. 1.

⁷ Shtojca 1 e Parashtrimeve, f. 3, para. 3.

⁸ Shtojca 1 e Parashtrimeve, f. 3, para. 2.

⁹ F00133, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 10 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 132(q). Versioni i korrigjuar u dorëzua më 14 dhjetor 2020 (F00133/COR). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 14 dhjetor 2020 (F00133/COR/CONF).

është aktualisht e klasifikuar si konfidenciale dhe lidhur me të cilën ZPS-ja, ZMMD-ja apo Mbrojtja e Viktimave nuk kanë propozuar redaktime, mund të riklasifikohet si publike, në varësi të paragrafit 7 më lart.

III. VENDIM

9. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **KONSTATON** se, me përjashtim të pjesëve të identifikuara në paragrafin 7 më lart, redaktimet e transkriptit të W01140-s identifikuar në Shtojcën 1 të Parashtrimeve, të propozuara nga ZPS-ja, ZMMD-ja dhe Mbrojtja e Viktimave, janë të domosdoshme dhe proporcionale, dhe se pjesët e mbetura të transkriptit janë të përshtatshme për riklasifikim dhe mund të riklasifikohen si publike;
- b) **MIRATON** redaktimet e propozuara në Shtojcën 1 të Parashtrimeve, në varësi të ndryshimeve të përcaktuara në paragrafin 7 më lart;
- c) **URDHËRON** ZPS-në t'i dërgojë Zyrës Administrative versionet publike me më pak redaktime të transkriptit të W01140-s në përputhje me redaktimet e miratuara në këtë vendim; dhe
- d) **URDHËRON** Zyrën Administrative të sigurojë, pas marrjes së versionit publik me më pak redaktime të transkriptit të W01140-s përmendur në nënparagrafin (c) më lart, që të njëjtat redaktime të zbatohen edhe në versionet në shqipe dhe serbishte të këtyre transkripteve, si dhe në incizimet përkatëse me audio dhe video, për aq sa është teknikisht e mundur.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 5 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.